



Ministria e Shëndetësisë Kosovo	Ministry of Health Republic of Kosovo
Milesi Origjinali Original No. 02	Nr. Protokollit Protocol No. 05-1159
Nr. i faqes Number of pages - 24 -	Data Date: 14/02/2025
Prishtinë / Pr	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada-Government**

**Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva- Ministry of Health**

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Ured Generalnog Sekretara -Office of the General Secretary

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

<b>REFERENCË:</b>		<b>R.V.2024</b>			
<b>PËR/ZA/TO:</b>		<b>Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë</b>			
<b>CC:</b>		<b>Të gjithë Udhëheqësve të Departamenteve.</b>			
<b>NGA/OD/FROM:</b>		<b>Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm</b>			
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>		<b>Raporti vjetor 2024.</b>			
<b>Nr. i zyrës:</b>	<b>115</b>	<b>Lokacioni:</b>	<b>MSh</b>	<b>Data:</b>	<b>15.02.2025</b>
<b>Br. kancelarije:</b>		<b>Kucni:</b>		<b>Datum:</b>	
<b>Room No.:</b>		<b>Extension:</b>		<b>Date:</b>	
<b>PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION</b>					<input type="checkbox"/>
<b>PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL</b>					<input type="checkbox"/>
<b>PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE</b>					<input type="checkbox"/>
<b>PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS</b>					<input type="checkbox"/>
<b>SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN</b>					<input type="checkbox"/>
<b>PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION</b>					<input checked="" type="checkbox"/>

I nderuar Ministër i Shëndetësisë Dr. Arben Vitia,

Të bashkëlidhur ju lutem gjeni raportin vjetor të Ministrisë së Shëndetësisë viti 2024.

Me respekt,



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*  
*Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health*  
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/ Ured Generalnog Sekretara/ Office of the Secretary General

# RAPORTI VJETOR 2024 MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Prishtinë, Shkurt 2025

## Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive.....	1
2. Ruajtja dhe përparimi i shëndetit.....	6
2.1 Shëndeti publik .....	6
2.2 Vaksinimi .....	7
3. Progresi me planin e punës – rezultatet e indikatorëve kyç të performancës.....	8
3.1 Hartimi i strategjive dhe i politikave .....	8
3.2 Zbatimi i programit dhe i planit legjislativ .....	8
3.3 Hartimi i Udhërrëfyesve dhe Protokolleve klinike .....	9
3.4 Zbatimi dhe përditësimi i Planeve kombëtare për zhvillim dhe integrim evropian.....	9
3.5 Shërbimet shëndetësore.....	10
3.5.1 Shërbimet transfuzive në QKKTGJ.....	11
3.5.2 Shërbimet shëndetësore në burgje.....	11
3.5.3 Shërbimet në Institutin special në Shtime.....	11
3.6 Furnizimi me barna për KPSH .....	12
3.7 Komunikimi me publikun .....	12
3.8 Zhvillimi i sistemit të informimit shëndetësor .....	12
3.9 Asistenca teknike dhe marrëveshjet financiare .....	13
3.10 Licencimi dhe akreditimi i institucioneve shëndetësore .....	14
3.11 Inspektimet.....	14
3.12 Pajisjet dhe produktet mjekësore .....	14
4. Pasqyra e performancës financiare .....	15
4.1 Shpenzimet kapitale dhe projektet .....	15
4.2 Prokurimi .....	16
5. Zbatimi i rekomandimeve të ZKA dhe të njësisë së brendshme të auditimit .....	17
5.1 Zbatimi i rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të auditimit për PVP 2022.....	17
5.2 Zbatimi i rekomandimeve të Zyrës së Avokatit të popullit .....	17
6. Planet për vitin e ardhshëm .....	18
7. Sfidat .....	18

## Shkurtesat

AQH	Accesible Quality Healthcare
BQShS	Bordi qendror për shkollim specialistik
DZhSSH	Departamenti për zhvillim strategjik shëndetësor
DPS	Divizioni për Planifikim Strategjik
DMV	Divizioni për Monitorim dhe Vlerësim
DShSh	Departamenti për shërbime shëndetësore
DCShSh	Divizioni për Cilësi të Shërbimeve Shëndetësore
DIEKP	Departamenti për integrim evropian dhe koordinim të politikave
DKP	Divizioni i komunikimit me publikun
DL	Departamenti ligjor
DI	Divizioni për infrastrukturë
DFShP	Departamenti për financa dhe shërbime të përgjithshme
DLAISH	Divizioni për licencim dhe akreditim të institucioneve shëndetësore
DShV	Divizioni i shërbimeve të veçanta
DShM	Divizioni i Shëndetit Mendor
DBNj	Divizioni i Burimeve Njerëzore
DTISHL	Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime të Logjistikës
GP	Grupi Punues
IKShPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IPSh	Institucionet private shëndetësore
Ish	Institucionet Shëndetësore
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
KPSH	Kujdesi parësor shëndetësor
I.DSh	Kujdesi dytësor shëndetësor
IKUPK	Këshilli Kosovar për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike
IBE	Lista e Barnave Esenciale
MSh	Ministria e Shëndetësisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OPSH	Odat e profesionistëve shëndetësorë
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PSO	Procedura Standarde Operative
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
ShSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
SP	Spital i Përgjithshëm
SISh	Sistemi i Informimit Shëndetësor
SMSF	Sistemi i menaxhimit të stokut farmaceutik
SIMBNj	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFK	Sistemi i Menaxhimit të Pasurisë Kapitale
TMM	Terapia mbajtëse me metadon
UPK	Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike

ZSP	Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
ZKM	Zyra e Kryeministrit

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Ministria e Shëndetësisë gjatë vitit 2024 është angazhuar në hartimin e politikave dhe zbatimin e ligjeve mbi bazën e një sistemi jo diskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor të bazuara në analiza profesionale dhe të dhëna shkencore. Gjatë kësaj periudhe janë përcaktuar norma dhe standarde për sektorin e shëndetësisë, duke i respektuar standardet përkatëse ndërkombëtare si dhe janë ndërmarr të gjitha masat e përcaktuara me ligj për realizimin e veprimeve të duhura me qëllim të zbatimit dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, banorëve dhe shfrytëzuesve të tjerë të shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor.

Në kuadër të ruajtjes së shëndetit publik, është zhvilluar mbikëqyrja dhe përcjellja e situatës epidemiologjike, në veçanti gripit dhe patogjenëve tjerë respiratorë, hulumtime të rasteve, përgatitje të raporteve dhe rekomandimeve dhe bashkëpunim me institucione vendore dhe ndërkombëtare të shëndetit publik. Gjatë vitit 2024 janë raportuar 277,616 raste të sëmundjeve ngjitëse me incidencë 15,577.9/100,000 banorë, që është numër më i lartë në krahasim me vitin 2023. Më së shumti raste të raportuara janë sëmundja e ngjashme me gripin (ILI) me 138,825 raste ose incidencë 7,789.9/100,000 banorë dhe kjo paraqet rritje në krahasim me vitin 2023 (129,315 raste). Gjithashtu janë raportuar 1,732 raste me COVID-19 që është numër më i ultë se në vitin 2023 (2,153 raste) ndërsa raste të importuara të sëmundjeve ngjitëse janë: 4 malarie, 1 Lija M dhe 1 morbill. Gjatë vitit 2024 janë raportuar 34 raste të reja me HIV, që paraqet rritje në krahasim me vitin 2023 (20 raste). Me qëllim të përmirësimit të raportimit të sëmundjeve ngjitëse janë realizuar vizita monitoruese në 25 institucione shëndetësore në institucione që ofrojnë shërbime për sëmundje ngjitëse si tuberkulozi dhe HIV me qëllim të monitorimit të përdorimit të sistemeve elektronike të menaxhimit për mbikëqyrje dhe kontroll të sëmundjeve ngjitëse.

Kalendari i rregullt i vaksinimit është përditësuar duke përfshirë edhe tre vaksinat vakcina të reja (Rota, Pneumo dhe HPV), ndërsa ka vazhduar vaksinimi sipas indikacioneve epidemiologjike dhe të trafikut ndërkombëtarë. Mbulimi me vaksinim sipas kalendarit të rregullt për vitin 2024, në nivel vendi është 87% (duke llogaritur DTaP1 – 95%, DTaP3 – 78 % dhe MMR1 - 88 %), si dhe janë vaksinuar edhe rreth 10,000 vajza të moshës 12 vjeç kundër HPV. Ministria e Shëndetësisë në fillim të sezonës së gripit 2024/2025 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale dhe nga 30 shtatori deri në fund të vitit 2024 janë administruar 64,011 doza. Komiteti profesional për këshillim dhe imunizim ka dhënë rekomandime për përfshirjen e djemve në vaksinimin HPV, për sigurimin e dozave për vaksinën kundër Lijës M dhe për vaksinimin vullnetar të vajzave deri në moshën 21 vjeç. Është zhvilluar edhe vaksinimi plotësues dhe fushata "*de.ë me derë*" për identifikimin dhe vaksinimin e fëmijëve të pa vaksinuar, veçanërisht në komunitetet e cenushme Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Bazuar në Planin e veprimit për vaksinim 2023-2026 janë zhvilluar aktivitete që synojnë rritjen e mbulimit të vaksinimit dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore përmes trajnimeve, vlerësimeve dhe fushatave të ndryshme, duke përfshirë vaksinimin kundër HPV të vajzave, si dhe vaksinimi sipas kalendarit të rregullt për fëmijët në komunitetet e cenushme.

Në përputhje me Planin e veprimit për përcaktimin e kriterëve për regjistrin e banorëve në kujdesin parësor shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë ka monitoruar zbatimin e kampanjës dhe kriteret e përzgjedhjes për mjekun familjarë dhe ka shpërndarë në drejtoritë komunale për shëndetësi broshurat dhe qarkoren informative 09/2024 për fushatën vetdijësuese për përzgjedhjen e mjekut familjar. Kjo kampanjë, pas periudhës testuese në katër komuna dhe regjistrimit të popullsisë për përcaktimin e numrit të saktë të banorëve, është zgjeruar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Përmes këtij procesi synohet krijimi i një liste të saktë të banorëve dhe pacientëve për mjekët familjarë, duke u fokusuar në një organizim më efektiv të shërbimeve shëndetësore. Këtë vit është aprovuar edhe regjistri zyrtar i profesionistëve shëndetësor.

Vizitat shëndetësore në shtëpi janë zbatuar në 34 komuna, ndërsa për kujdes paliativ në 30 komuna. Numri i vizitave mjekësore në shtëpi për nënën dhe fëmijë 0-3 vjeç për vitin 2024 është 39,554 ndërsa për kujdesin paliativ 116, 036 vizita. Ministria, ka furnizuar me barna dhe materiale shpenzuese institucionet e kujdesit parësor shëndetësor, ku janë siguruar barna për QKMF me porosi të rregullta dhe emergjente me një përqindje prej 85% për barna dhe 90% me material shpenzues, ndërsa furnizimi me insulina, vaksina dhe terapi antituberkulare është 100%. Ministria në vitin 2024 ka siguruar 26 produkte të reja për barna e sëmundjeve të rralla, ndërsa furnizimi me barna për programe specifike fibroza cistike, okrelizumab, dornase alfa, interferon Beta1a22mcg, Interferon Beta1amcg, interferon Beta1b 250mcg, taliglucerase, imiglucerase është 100%.

Angazhimi në hartimin e planeve strategjike dhe planeve të veprimit ka rezultuar me miratimin e Strategjisë sektoriale shëndetësore 2025-2030 nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia sektoriale e shëndetësisë 2025-2030 (SSSh) reflekton prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për sektorin e shëndetësisë, të përcaktuara në Strategjinë dhe planin kombëtar për zhvillim 2030 të reflektuara edhe në Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2025-2027. Strategjia përmes objektivave strategjike “Përmirësimi i cilësisë dhe qasjes në shërbime shëndetësore” dhe “Ruajtja dhe përparimi i shëndetit” do të kontribuojnë në ruajtjen, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës përmes sigurimit të qasjes universale dhe të barabartë në shërbime shëndetësore cilësore dhe të sigurta, të arritshme dhe të përbalueshme për të gjithë qytetarët e vendit. Qeveria e Republikës së Kosovës, gjithashtu ka miratuar edhe Planin strategjik për sistemin e informimit shëndetësor 2024-2030. Plani Strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030 është hartuar me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të informimit shëndetësor në Kosovë. Ministria e Shëndetësisë përmes këtij plani strategjik do të rishikojë statusin aktual të zhvillimeve të sistemit të informimit shëndetësor, për të rivendosur qasjen për arkitekturën kombëtare të shëndetësisë digjitale dhe planet për zhvillimin gjithëpërfshirës të sistemit të informimit shëndetësor në të ardhmen. Të dhënat analitike në dispozicion imponuan domosdoshmërinë për të rekomanduar investimin në një sistem kombëtar të informimit shëndetësor, që do të mundësojë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë dhe të sigurisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët e saj në periudhën afatmesme nga viti 2024 deri në vitin 2030. Edhe pse ky synim është ambicioz, ai është i arritshëm me parakushtet që duhet të sigurohen resurset e nevojshme të përcaktuara qartë dhe në detaje në Studimin e Fizibilitetit 2023.

Përgjatë kësaj periudhe po ashtu janë miratuar plane strategjike që synojnë të zhvillojnë fusha të rëndësishme të shëndeti publik sikurse, Plani i veprimit për siguri shëndetësore 2024-2026 që siguron se kapacitetet kombëtare për parandalim, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje të emergjencave shëndetësore të jenë të planifikuara, krijuara, fuqizuara dhe të kenë qëndrueshmëri në mënyrë që të arrihet siguria shëndetësore kombëtare, regjionale dhe globale. Në vitin 2024 është përditësuar Programi i zgjeruar i imunizimit me përfshirjen e vaksinave të reja (HPV, RotaVirus, Pneumovirus) dhe Plani i veprimit për avokim, komun kim dhe mobilizim social për vaksinat e reja në kalendarin e vaksinimit. Ministria ka miratuar edhe Planin strategjik kombëtar për laboratorë në Kosovë 2024-2030, Programin për skring neonatal, Planin i veprimit për KPSH 2024-2026, Planin i komunikimit 2024-2026, dokumentin “Digital Health Blueprint” – instrument i qartë për shtrirjen e plotë të sistemit të informimit shëndetësor në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor dhe Planin i veprimit për TB, HIV dhe IST 2025-2027.

Me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë ka vazhduar diskutimet me Bankën zhvillimore të Këshillit të Evropës dhe Bankën investuese Evropiane me qëllim të sigurimit të financimit për zbatimin e studimit të fizibilitetit “*përmirësimi i infrastrukturës fizike të institucioneve të kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar 2023-2026*” që parasheh investime në pajisje dhe infrastrukturë në institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor në Republikën e Kosovës. Përmes këtij plani strategjik parashihet sigurimi i pajisjeve për spitale të përgjithshme dhe klinikat e QKUK në vlerë prej rreth 50-milion euro. Gjatë vitit 2024 ka vazhduar studimi i fizibilitetit i fazës së dytë ku do të realizohet vlerësimi për korridoret e ngrohta, qasjen për personat me aftësi të kufizuara dhe Hospica. Mjetet financiare për realizimin e këtij studimi 1 milion euro, janë ndarë nga Korniza investuese e Ballkanit perëndimorë. Vlerësimi final dhe raporti me rekomandime pritet të finalizohet në Qershor 2025.

Qendra kombëtare e Kosovës për transfuzionin e gjakut është angazhuar në realizimin e misionit të saj primar, sigurimin e gjakut dhe përbërësve të gjakut, duke qenë maksimalisht e fokusuar në vendosjen e cilësisë dhe sigurisë në grumbullimin, testimin, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e gjakut dhe përbërësve të gjakut si dhe ruajtjen e shëndetit të dhuruesve të gjakut dhe pacientëve pranues të gjakut. Në vitin 2024 fokusi i QKTGJK është vënë në drejtim të ngritjes së cilësisë dhe sigurisë të gjakut dhe përbërësve të gjakut duke filluar me rritjen e numrit të dhurimeve të gjakut të cilat shënuan trend pozitiv dhe u realizuan 31,555 dhurime të gjakut.

Instituti special në Shtime ofron përkujdesje për 70 rezidentë. Kujdesi mjekësor ka qenë i përqendruar në ruajtjen e shëndetit dhe mbështetje për këtë grup pacientësh përmes kontrolleve rutinë mjekësore, trajtimeve gjithëpërfshirëse, kontrolleve sistematike dhe periodike, me qëllim përmirësimin e shëndetit, lehtësimin e jetës dhe menaxhimin e sjelljeve të tyre. Departamenti shëndetësor i burgjeve ka funksionuar në njëmbëdhjetë (11) njësi shëndetësore të burgjeve me shërbim 24 orësh. Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit është bërë përmes inspektorateve shëndetësore, farmaceutike dhe sanitare ku janë realizuar 15,503 inspektime.

Në zbatim të programit legjislativ, në Kuvend është miratuar projektligji për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor i cili është dërguar nga subjektet politike në Gjykatën Kushtetuese. Gjithashtu Qeveria ka miratuar Projektligjin për Inspektoratin qendror të shëndetësisë dhe Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, tregtimin, kontrollin e duhanit, produkteve të duhanit dhe produkteve të ndërlidhura. Me qëllim të zbatimit të legjislacionit në fuqi janë miratuar nga Qeveria, rregullorja Nr.15/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe rregullorja (qrk) nr. 30/2024 për procedurën e pranimin të nëpunësve të shërbimit publik në sektorin e shëndetësisë. Ndërsa Ministria e Shëndetësisë ka miratuar gjashtë aktet nënligjore sikurse udhëzimi Administrativ (shëndetësi) nr.01/2024 variacionet e produkteve medicinale, udhëzimi Administrativ nr.02/2024 për plotësimi dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ (Shëndetësi) nr. 05/2023 vërejtjet e kombinuara, udhëzimi Administrativ nr. 03/2024 - bashkë pagesat për shërbimet shëndetësore, udhëzimi administrativ (shëndetësi) nr.04/2024 për mbështetjen e dhuruesit të gjakut, Statuti (Msh) Nr. 01/2024 i Institutit Kombëtar të shëndetësisë publike të Kosovës dhe Rregullorja Nr.01/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Ministria, pas miratimit të Planit strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030 është fokusuar në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara sipas afateve dhe prioriteteve të fushave përkatëse. Gjatë vitit 2024, është zhvilluar moduli për përzgjedhje të mjekut familjar dhe është mundësuar ndërlidhja dhe integrimin e sistemit për mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse në kuadër të sistemit BHIS ku të gjitha institucionet në KPSH do të mund të raportojnë sëmundjet ngjitëse bazuar në Ligjin Nr.08/L-200 për parandalim dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse. Në kuadër të SMSF-së është zhvilluar moduli për planifikim dhe dispensim të Metadon-it, i cili përfshin planifikimin, furnizimin, shpenzimin dhe janë përditësuar modulet ekzistuese. Në zbatim të Planit Strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030 është zhvilluar “*Digital Health Blueprint*” – instrument i qartë për shtrirjen e plotë të sistemit të informimit shëndetësor në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor. Një intensifikim i aktiviteteve pritet pas fillimit të zbatimit të kredisë së Bankës Botërore që do të mbështet zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor me rreth 12 milion euro.

Në fushën e pajisjeve dhe produkteve mjekësore është vazhduar me vlerësimin e dokumentacionit në procesin e lëshimit dhe ripërtëritjes të certifikatave të autorizim marketingut, vlerësimin të variacioneve si dhe aktivitetet e farmakovigjilencës me referencë të veçantë për aktivitetet e menaxhimit të rrezikut, aktivitetet e licencimit të veprimtarive, lejeve të importit dhe analizat laboratorike të kontrollit cilësisë.



Në kuadër të agjendës evropiane dhe koordinimit të politikave është monitoruar niveli i zbatimit të Planit kombëtar për zhvillim (PKZH), Programit kombëtar për integrim evropian (PKIE), Programit për Reforma në Ekonomi 2024 – 2026. Gjithashtu janë përgatitur edhe raporte të veçuara për nivelin e zbatimit të Programit të Qeverisë 2021-2025 dhe nivelin e zbatimit të konkluzioneve të Nën-komitetit të MSA-së “Tregun e brendshëm, konsumatorin dhe shëndeti publik”. Niveli i zbatimit të këtyre dokumenteve strategjike ka shënuar një ngritje krahasuar me vitet tjera me theks në hartimin e politikave, legjislacionit dhe masave zbatuese. Raporti zyrtar nga ZKM për nivelin e zbatimit të këtyre dokumenteve do të publikohet në tremujorin e parë të vitit 2025. Në tremujorin e fundit të vitit 2023 janë hartuar draftet e Programit Kombëtar për Zhvillim 2025-2027 (PKZH-2027-2027), në kuadër të sektorit të shëndetësisë. Në tetor të vitit 2024 është publikuar nga Komisioni Evropian Raporti i Kosovës 2024. Ministria, fillimisht është fokusuar në evidentimin e sfidave të dala nga raporti i Komisionit Evropian për Kosovë 2024 dhe të njëjtat sfida i ka ndarë me të gjitha institucionet përgjegjëse në sektorin e shëndetësisë. Mbi bazën e këtij raporti, Ministria e Shëndetësisë ka hartuar draftin final të Programit Kombëtar për Integrim Evropian 2025.

Ministria, në komunikim me publikun ka qenë kryesisht i fokusuar në prezantimin e aktiviteteve të ndërlidhura me prioritetet kryesore, siç janë miratimi i politikave të reja, promovimi i aktiviteteve ku është përmirësuar infrastruktura, dhe pajisjet në institucionet shëndetësore, furnizimi me barna, si dhe fushatat për vetëdijesimin e publikut rreth shëndetit publik, me theks promovimi i kampanjës për përzgjedhjen e mjekut familjar në zonën e banimit, procesi i vaksinimit kundër gripit sezonal, dhe shënimi i ditëve dhe javëve botërore të shëndetit publik.

Performanca financiare është veçuar me shpenzim të buxhetit prej 71.28 % bazuar në buxhetin fillestar ndërsa sipas buxhetit final 83.02 %. Krahasuar me vitet paraprake përqindja e shpenzimit të buxhetit ishte 25.97 %, me e lartë se 2023 dhe 60.32 % më e lartë se në vitin 2022. Ministria e Shëndetësisë në vitin 2024 ka planifikuar 147 aktivitete për furnizime, shërbime dhe punë. Janë nënshkruar 285 kontrata me një vlerë totale prej 41,252,919.65 €. Në total, janë regjistruar 57 ankesa, gjatë procedurave të prokurimit ku 39 ankesa janë në favor të autoritetit kontraktues, 5 ankesa janë pjesërisht të bazuara, ku janë identifikuar disa elemente që kërkojnë rishikim ose sqarim të mëtejshëm dhe 13 ankesa janë të natyrës së ri-vlerësimit, që kërkojnë një analizë të mëtejshme të ofertave dhe procesit të vlerësimit, për të siguruar që çdo aspekt i procedurës është zbatuar në përputhje me rregullat dhe kriteret e përcaktuara. Investimet kapitale në vitin 2024 janë kryesisht vazhdimësi e projekteve nga vitet e kaluara të cilat nuk kanë mundur të fillojnë me kohë si rrjedhojë e projekteve të mangëta dhe jo profesionale. Gjithsesi Ministria me qëllim të ngritjes së nivelit të shfrytëzimit të mjeteve për investime kapitale vitit 2024 ka ndërmarrë hapat e nevojshme që projektet kapitale të parapara për vitin 2025 dhe mjetet e ndara financiare për këtë qëllim të shfrytëzohen maksimalisht dhe brenda afatit të përcaktuar.

Në fushën e bashkëpunimit, Ministria në vitin 2024 ka nënshkruar marrëveshjen me Federatën botërore të Hemofilisë me seli në Kanada që do të mundësojë ngritjen e cilësisë të kujdesit dhe trajtimit për pacientët që vuajnë nga hemofilia në Kosovë dhe gjithashtu të përmirësojë mbledhjen e të dhënave në lidhje me rezultatet shëndetësore të personave me Hemofili. Kosova, është anëtarësuar në Komitetin për barna esenciale në Critical Medical Alliances. Ministria e Shëndetësisë, ka nënshkruar kontratat me dhjetë Organizata Joqeveritare (OJQ) që kanë përfituar nga mbështetja financiare sipas thirrjes publike “Promovimi i Shëndetit Mendor, Promovimi dhe Parandalimi i Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB, si dhe fuqizimi i të rinjve për një jetë të shëndetshme”. OJQ-të do të zhvillojnë aktivitete parandaluese, promovuese, edukative dhe avokuese, ndërsa buxheti i ndarë është 132,000 euro.

Në kuadër të koordinimit të asistencës teknike, Ministria ka marrë konfirmimin nga Ministria e Financave punës dhe transfereve që projekti kreditë i financuar nga Banka Botërore “Qasja gjithëpërfshirëse e Kosovës për forcimin e sistemit të shëndetësisë,” është proceduar në kuvend për miratim. Sa i përket Planit strategjik për sigurimin e pajisjeve për të gjitha institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor, Ministria është në proces të finalizimit të diskutimeve rreth financimit të me Bankën zhvillimore të Këshillit të Evropës dhe Bankën investuese të Evropës.

Aktualisht, është duke u zhvilluar studimi i fizibilitetit WB21-KOS-SOC-01 me komponentët e lidhjes së korridoreve të ngrohta në mes klinikave në SHSKUK, qasjen e personave me aftësi të kufizuar në institucione shëndetësore dhe vlerësimin për kujdesin paliativ në tri nivelet e kujdesit shëndetësor përfshirë Hospicën. Në kuadër të komunikimit me ekipin për zbatimin e studimit të fizibilitetit IPF 11, është rekomanduar që në vlerësim të përfshihen praktikat më të mira të vendeve të Evropiane sa i përket kujdesit paliativ, përfshirë edhe Hospicën. Ministria e Shëndetësisë në vitin 2024 ka përfituar donacione me vlerën e përgjithshme prej 18,610,655.83 euro.

Në kuadër të përgjegjësisë për zbatim të rekomandimeve të Njesisë së brendshme të auditimit për vitin 2024 ka zhvilluar gjithsej 12 procese auditimi, ku janë dhënë 34 rekomandime dhe sugjerime, të cilat kanë pasur për qëllim mbështetje të menaxhmentit në përmbushjen e përgjegjësisë të tyre për efikasitetin dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit në arritjen e objektivave. Për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, është planifikuar që 20 rekomandime të zbatohen në vitin 2024. Ministria ka arritur që 19 rekomandime ti adresoj plotësisht (95%), ndërsa një (1) rekomandim (5%) ende nuk është adresuar, ndërkohë që 14 rekomandimet tjera nga zyrtarët përgjegjës janë paraparë për zbatim gjatë vitit 2025.

Raporti i Zyrës kombëtare të auditimit për pasqyrat vjetore financiare 2023 të Ministrisë së Shëndetësisë ka evidentuar katër (4) të gjetura. Për adresimin e këtyre të gjeturave dhe adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra kombëtare të auditimit (ZKA), Ministria në vitin 2024 ka hartuar planin për zbatimin e rekomandimeve të ZKA për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2023. Bazuar në raportin për zbatimin e planit të veprimit nga katër (4) rekomandime, një (1) është zbatuar tërësisht dhe tri (3) janë në proces të zbatimit.

Sa i përket zbatimit të rekomandimeve të Zyrës së Avokatit të popullit, gjatë vitit 2024 në vazhdimësi Ministria ka adresuar rekomandimet e dala nga raporti në institucionet relevante dhe përgjigjet e pranuar nga institucionet përgjegjëse janë përcjellë Zyrës së Avokatit të popullit. Ministria gjatë kësaj periudhe ka dorëzuar raporte të rregullta ku nga rekomandime, 20 janë zbatuar plotësisht, 7 janë në proces të zbatimit dhe 4 prej rekomandimeve nuk janë zbatuar.

Ministria e Shëndetësisë sipas Rregullores Nr.15/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MSh, gjatë vitit 2024 ka rekrutuar tridhjetë (30) pozita ndërsa në procedurë janë pesëmbëdhjetë (15) pozita.

## 2. Ruajtja dhe përparimi i shëndetit

### 2.1 Shëndeti publik

Në kuadër të ruajtjes së shëndetit publik, është zhvilluar mbikëqyrja dhe përcjellja e situatës epidemiologjike, në veçanti gripit dhe patogjenëve tjerë respiratorë, hulumtime të rasteve, përgatitje të raporteve dhe rekomandimeve dhe bashkëpunim me institucione vendore dhe ndërkombëtare të shëndetit publik.

#### *Indikatorët bazë të performancës*

- Një (1) Modul digjital për mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse i funksionalizuar;
- 277,616 raste të sëmundjeve ngjitëse me incidencë 15,577.9/100,000 banorë ( në vitin 2023 kanë qenë 129,315 raste);
- Vaksinat kundër COVID të siguruara;
- 1,732 raste me COVID-19 (në vitin 2023 kanë qenë 2,153 raste);
- 34 raste të reja me HIV ( në vitin 2023 kanë qenë 20 raste);
- Qendrat operative emergjente në QRSHP të themeluara;
- Studim longitudinal për sëmundjet kronike jo ngjitëse në mesin e shfrytëzuesve të kujdesit parësor shëndetësor në Kosovë i hartuar;
- Analiza periodike të situatës epidemiologjike me influencë dhe patogjen i tjerë respirator (DE) të realizuara;
- Studimi i Mbikëqyrjes së Integruar të sjelljeve dhe biologjike për HIV në Kosovë”, “Përcaktimi i madhësisë së popullatës, kyçe” dhe “Mappingu i popullatës kyçe” i realizuar;
- Evidenca epidemiologjike për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve kronike jo ngjitëse;
- Raportet i Morbiditetit në të tre nivelet e kujdesit shëndetësor të përfunduara;
- Një (1) plan vjetor i monitorimit të ujit për pije i realizuar;
- Një (1) raport vjetor për vlerësimin e kushteve higjieniko-sanitare dhe mikroklimatikë i përfunduar
- Një (1) raport vjetor i vlerësimit të kushteve mikroklimatikë në amvisëri dhe prevalenca e morbiditetit të popullatës i përfunduar;
- Dy (2) analiza të përgatitur për situatën epidemiologjike me COVID-19, projeksionet dhe të dhënat nga laboratorit për sekuencionim;
- Dymbëdhjetë (12) Buletinet mujore për sëmundje ngjitëse të shpërndara;
- Situata epidemiologjike me Sindromën meningjeale, me Hepatit B dhe Hepatiti, me ethet hemorragjike dhe sëmundjet që përhapen me ujë dhe ushqim, të sëmundjeve zoonozotike, me HIV/AIDS/IST të mbikëqyrura;
- Situatat epidemiologjike të sëmundjeve që përhapen (Borrelioza, Malaria, WNV, Leishmaniaza) të mbikëqyrur;
- Hulumtimet dhe gjurmimet e kontakteve me Mpox të mbikëqyrura.

## 2.1 Vaksinimi

Sa i përket vaksinimit kundër COVID-19 Ministria e Shëndetësisë bazuar në Planin për vaksinim ka siguruar dozat e mjaftueshme për vakcina kundër COVID-19 për vitin 2023, por përgjigja e qytetareve për vaksinim vazhdon të jetë në nivelin më të ultë prej fillimit të procesit të vaksinimit dhe si rrjedhojë kemi skadim të afatit të përdorimit të vaksinave.

### *Indikatorët bazë të performancës*

- Vaksinat sipas indikacione epidemiologjike dhe trafik ndërkombëtar kanë mbuluar nevojat 100% të qytetarëve;
- Janë siguruar të gjitha vaksinat e kalendarit të rregullt nga MSh, përfshirë edhe tri vaksinat e reja (vakcina kundër Pneumokok. Rotavirusit dhe HPV)
- 87 % mbulimi me vakcina të kalendarit të rregullt;
- Janë mbajtur 350 sesione informuese nga profesionistet shëndetësor të KPSH për prindërit dhe mësuesit në shkolla për vaksinimin kundër HPV, duke mbuluar 4,311 prindër;
- 10,000 vajza të moshës 12 vjeç janë vaksinuar me vaksinën kundër HPV;
- 85,000 doza të vaksinës sezonale me ç ‘rast janë administruar 64,011 vakcina;
- Është duke u zbatuar Plani për evokim, komunikim dhe mobilizim social për tre vaksinat e përfshira në kalendarin e rregullt të vaksinimit;
- Një (1) plan i veprimt për vaksinim 2022-2025 i reviduar;
- Një (1) raport i hartuar për efektet pasvaksinale të padëshiruara;
- Një (1) raport mujor përgatitur për stokun e vaksinave në platformën digjitale VIVA i realizuar;
- 151 punëtorë shëndetësorë të vaksinuar nga ekipi mobil në vendin e punës;
- Sigurimi dhe vaksinimi i pesë kontakteve të afërta të rastet index rastit me Mpox;
- Furnizimi me vaksinat kundër Rabiesi

### **3. Progresi me planin e punës – rezultatet e indikatorëve kyç të performancës**

#### **3.1 Hartimi i strategjive dhe i politikave**

Me qëllim të realizimit të synimeve strategjike dhe atyre specifike të parapara në Planin kombëtar për zhvillim, Ministria e Shëndetësisë ka miratuar plane strategjike dhe plane të veprimit. Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2023-2030 dhe Plani Strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030, janë miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

##### ***Indikatorët bazë të performancës***

- Strategjia sektoriale e shëndetësisë 2023-2030 e miratuar;
- Plan strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030 i miratuar;
- Plani strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030 i miratuar;
- Strategjia sektoriale e shëndetësisë 2025-2030 e miratuar;
- Plani strategjik dhe plani i veprimit për TB, HIV dhe IST 2025-2027 i miratuar;
- Plan i integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë i përditësuar;
- Plani i veprimit për zbatimin dhe monitorimin e programit psikosocial me aktivitete për trajtimin e rasteve me problem të shëndetit mendor në burgje i miratuar;
- Plani i veprimit për planin e avokimit, komunikimit dhe mobilizimit social për vaksinat e reja në kalendarin e vaksinimit i miratuar;
- Plani i veprimit për parandalim, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje për pandeminë me patogjen respirator i miratuar;
- Plani i veprimit për monitorimin e zbatimit të kontrollit të duhanit i miratuar;
- Plani i veprimit për vaksinim 2024-2026 i përditësuar;
- Plani strategjik për KPSH 2024-2026 i miratuar;
- Plani i Komunikimit 2024-2026 i miratuar;
- Plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të performancës “lista e pritjes së pacientëve në institucionet shëndetësore publike i miratuar;
- Plani i veprimit për tranzicionin e aktiviteteve të programit specialistik të Mjekësisë familjare nga projekti “Programi për përkrahjen e shëndetësisë në Kosovë, faza II” në Ministrinë e Shëndetësisë i miratuar;
- Plani i veprimit për funksionalizimin e hemodializes në Rahovec i miratuar;
- Plani i veprimit për fuqizimin dhe modernizimin e shërbimit të trajtimit të sëmundjes së epilepsisë me stimulim të nervit vagus (VNS) për epilepsi farmakorezistente i miratuar.

#### **3.2 Zbatimi i programit dhe i planit legjislativ**

Në zbatim të programit legjislativ, në Kuvend është miratuar projektligji për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor i cili është dërguar në Gjykatën Kushtetuese. Në Qeveria është miratuar Projektligji për inspektoratin qendror të shëndetësisë dhe Projektligji për prodhimin, grumbullimin, tregtimin, kontrollin e duhanit, produkteve të duhanit dhe produkteve të ndërlidhura. Ministria, ka shqyrtuar 21 lëndë për vlerësim të ligjshmërisë së akteve komunale nga Komunitet e ndryshme të Kosovës.

##### ***Indikatorët bazë të performancës***

- Projektligji për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor i miratuar në kuvend;
- Projektligji për inspektoratin qendror të shëndetësisë është aprovuar në Qeveri;
- Projektligji për prodhimin, kultivimin, grumbullimin, tregtimin, kontrollin e duhanit, produktet e duhanit dhe produktet e ndërlidhura, është aprovuar në Qeveri.

#### **Aktet nënligjore të miratuara nga Qeveria:**

- Rregullorja Nr.15/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Shëndetësisë e miratuar;
- Rregullorja Nr. 30/2024 për procedurën e pranimit të nëpunësve të shërbimit publik në sektorin e shëndetësisë e miratuar;

#### **Aktet nënligjore të nxjerrë nga Ministri i shëndetësisë:**

- Udhëzimi Administrativ (shëndetësi) Nr. 01/2024 variacionet e produkteve medicinale;
- Udhëzimi Administrativ Nr.02/2024 për plotësimi dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ (Shëndetësi) Nr.05/2023 vërejtjet e kombinuara;
- Udhëzimi Administrativ Nr.03/2024 bashkë pagesat për shërbimet shëndetësore;
- Udhëzimi Administrativ (shëndetësi)Nr.04/2024 për mbështetjen e dhuruesit të gjakut;
- Statuti (Msh) Nr. 01/2024 i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës;
- Rregullorja Nr.01/2024 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës;

### **3.3. Hartimi i udhërrëfyeseve dhe Protokolleve Klinike**

Në procesin e hartimit të standardeve dhe praktikave të mira shëndetësore, përmes hartimit të udhërrëfyeseve klinik, dhe protokolleve klinike gjatë vitit 2024 janë hartuar dhe miratuar dy udhërrëfyese klinik dhe dy protokolle klinike. Ndërsa në proces të hartimit janë 61 Udhërrëfyese klinik dhe 6 Protokolle klinike.

#### ***Indikatorët bazë të performancës***

- Një (1) Udhërrëfyese klinik për menaxhimin dhe trajtimin e dhunës seksuale i miratuar;
- Një (1) Udhërrëfyese klinik për trajtimin e pacientëve me çrregullime obsesive kompulsive i miratuar;
- Një (1) Protokoll klinik për trajtimin e sëmundjes së sheqerit tip 2 me atidiabetik oral të rriturit i miratuar;
- Një (1) Protokoll klinik për menaxhim farmakologjik me preparate injektuese joinsulinike dhe insulinate të sëmundjes së sheqerit tip 2 i miratuar.

### **3.4 Zbatimi dhe përditësimi i Planeve kombëtare për zhvillim dhe integrim evropian**

Në kuadër të agjendës evropiane, gjatë vitit 2024, Ministria ka vazhduar në zbatimin e obligimeve që dalin nga ky proces. Në kuadër të planifikimit strategjik të qeverisë është hartuar Planit kombëtar për zhvillim 2025-2027 dhe Plani kombëtar për integrim evropian (PKIE) 2025 për sektorin e shëndetësisë duke i reflektuar të gjeturat e raportit të progresit të Komisionit Evropian për Kosovë 2024. Sa i përket koordinimit të politikave është bërë monitorimi i zbatimit të Planit Kombëtar për Zhvillim 2024-2026 dhe Plani kombëtar për integrim evropian 2024-2026.

#### ***Indikatorët bazë të performancës***

- Dy (2) raporte të përgatitura për kontributin e parë dhe të dytë për raportin e KE-së për Kosovën – 2024 /Shëndeti Publik;
- Dy (2) raport i përgatitur për kapitullin e 28 me pyetjet shitesë të Komisionit Evropian;
- Dy (2) raport i përgatitur për kapitullin e 3 me pyetjet shitesë të Komisionit Evropian;
- Dy (2) raport i përgatitur për kapitullin e 1 me pyetjet shitesë të Komisionit Evropian;
- Një (1) raport i përgatitur raport vjetor mbi nivelin e zbatimit të aktiviteteve në kuadër të Programit kombëtar për integrim evropian për takimin e VI të Këshillit Ministror për Integrim Evropian;

- Një (1) raport i përgatitur për PKIE (Janar- Shtator) masat legislative dhe zbatuese 2024 në platformën online, sipas kërkesës së zyrës së Kryeministrit;
- Një (1) raport i vendit 2024 i publikuar nga KE për Kosovë dhe është përcjellë bashkë me të gjeturat për sektorin e shëndetësisë;
- Një (1) raport i përgatitur për zbatimin e konkluzioneve të Nën komitetit për tregun e brendshëm, konkurrencën, shëndetësinë dhe mbrojtjen e konsumatorit 2023-2024;
- Një (1) raport vjetor për zbatimin e Planit kombëtar për zhvillim i hartuar;
- Një (1) Plani i Integritetit institucional 2024-2026 i miratuar;
- Një (1) raport vjetor mbi zbatimin e Planit të Integritetit 2023-2025 i përgatitur;
- Katër (4) raporte tremujore të përgatitura për zbatimin e Planit kombëtar për zhvillim 2024-2030 për Ministrinë e Shëndetësisë;
- Katër (4) raporte tremujor të përgatitura për Ministrinë e Shëndetësisë;
- Dy (2) projekt-marrëveshje të përgatitura për bashkëpunim në fushën e sëmundjeve ngjitëse janë proceduar në ECDC;
- Dy (2) raporte të përgatitura për të arriturat e Ministrisë gjatë mandatit të Qeverisë;
- Dy (2) raporte gjashtë mujore për nivelin e zbatimit të Planit të Integritetit Institucional;
- Është monitoruar zbatimi i vendimeve të Qeverisë për vitin 2024.

### 3.5. Shërbimet shëndetësore

Përmes këtij procesi synohet krijimi i një liste të saktë të banorëve dhe pacientëve për mjekët familjarë, duke u fokusuar në një organizim më efektiv të shërbimeve shëndetësore. Me qëllim të përmirësimit të raportimit të sëmundjeve ngjitëse janë realizuar vizita monitoruese në 25 institucione shëndetësore në institucione të shëndetit publik që ofrojnë shërbime për sëmundje ngjitëse si tuberkulozi dhe HIV me qëllim të monitorimit të përdorimit të sistemeve elektronike të menaxhimit për mbikëqyrje dhe kontroll të sëmundjeve ngjitëse. Këtë vit është aprovuar regjistri zyrtar i profesionistëve shëndetësor. Vizitat shëndetësore në shtëpi janë zbatuar në 34 komuna, ndërsa për kujdes paliativ në 30 komuna.

#### *Indikatorët bazë të performancës*

- Monitorim i zbatimit të vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë;
- Një (1) raport i përditësuar për Health Protection në zyre e OBSH-së, për të arriturat në fushën e shëndetit Mendor;
- Një (1) raport i përgatitur për zbatimin e 12 rekomandimeve të Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale/ KSHMS për shëndet mendor;
- Një (1) Program për skrining neonatal i miratuar;
- Një (1) raport lidhur me situatën epidemiologjike të COVID-19 i analizuar;
- Një (1) raport për TB, HIV dhe sëmundjeve tjera ngjitëse i hartuar;
- Planifikimi i barnave ARV, ATB dhe materialit hargjues për periudhën 2025-2027 i përgatitur;
- Aktivitetet e planifikuara për shëndetin mendor për vitin 2024, të hartuara;
- Një (1) Plan i veprimit për ndërhyrjen në fëmijërinë e hershme NFH/ECI i finalizuar;
- Një (1) procedurë standarde operative (PSO) për skriningun neonatal e miratuar;
- Një (1) raport për zbatimin e rekomandimeve nga IAP – (Rasti Ex Officio Nr 530/2023, lidhur me vlerësimin e trajtimit dhe respektimit të të drejtave të pacientit);
- Një (1) matricë për monitorimin e planit të veprimit për HIV dhe TB 2022-2024 për muajt tetor-dhjetor e finalizuar;
- Një (1) analizë e raportit të programit të terapisë me metadon nga Qendra zbatuese;
- Një (1) kërkesë për aprovim të buxhetit për kontakte sociale për vitet 2025-2027 e aprovuar;
- Një (1) plan i veprimit për regjistrin e banorëve në KPSH i miratuar;
- Një (1) Modul për regjistrin e banorëve në KPSH i zhvilluar;
- 39, 554 vizita në shtëpi për shtatzëna dhe për fëmijët 0-3 vjeç të realizuara;
- 34, 744 vizita në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç të realizuar;
- 4, 810 vizita në shtëpi për shtatzëna të realizuara;
- 16, 522 fëmijë 0-3 vjeç janë vizituar për herë të parë;
- 1, 613 fëmijë 0-3 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë;

- 2, 738 shtatzëna që janë vizituar për herë të parë;
- 436 shtatzëna nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë;
- 576 fëmijë janë referuar te specialistët mjekësorë nga ekipi i mjekësisë familjare;
- 16 raste të dhunës të identifikuar (nga observimi gjatë vizitës në shtëpi);
- 153 fëmijë janë identifikuar me ngecje në zhvillim dhe të referuar (nga observimi gjatë vizitës në shtëpi);
- 116, 036 vizita mjekësore për kujdesin paliativ nga 30 komuna që kanë raportuar;
- Një (1) listë e mjekëve të përgjithshëm dhe specialisteve për tu përzgjedhur si mjek familjarë e finalizuar;
- Një (1) Qarkoje informative Nr. 09-2024 e finalizuar dhe e proceduar për fillimin e fushatës vetdijësuese për përzgjedhjen e mjekut familjar;
- Ri akreditimi i programit specialistik 3 vjeçar për Mjekësi Familjare nga RCGP i përditësuar;
- Një (1) plan i veprimit për “Tranzicionin e aktiviteteve të programit specialistik të Mjekësisë Familjare nga projekti Programi për përkrahjen e shëndetësisë në Kosovë, Faza II-KSV/017 (LUX-DEV) në Ministrinë e Shëndetësisë” i miratuar;

### **3.5.1. Shërbimet transfuzive në QKKTGJ**

- 32,651 paraqitje për dhurim;
- 1,096 dhurime të refuzuara;
- 31.555 dhurime efektive të gjakut;
- 99 dhurime më shumë në vitin 2024 në nivel Kosovës;
- 245 dhurime vullnetare më shumë në vitin 2024 në nivel Kosovës;
- 74.7% dhurime vullnetare në tërë territorin e Kosovës;
- 0.5 % rritje të dhurimeve vullnetare në tërë Kosovën;
- 88.3% dhurime vullnetare në QKKTGJ Prishtinë;
- 60.4% e dhurimeve të realizuara në QKKTGJ Prishtinë;
- 39.6% e dhurimeve të realizuara në Qendrat e Transfuzionit regionale.

### **3.5.2. Shërbimet shëndetësore në burgje**

- 93,255 shërbime shëndetësore të realizuara;
- 25,275 vizita sistematike të realizuara;
- 5,117 intervista psikologjike;
- 2,264 analiza laboratorike;
- 11.80% përdorues të drogave;
- Ka vazhduar trajtimi me metadon i përdoruesve të drogave të burgosur sipas indikacioneve.

### **3.5.3. Shërbimet në Institutin special në Shtime**

- 883 kontrolle të rregullta dhe sipas rastit;
- 297 kontrolle psikiatrike;
- 89 intervenime psikologjike;
- 103 kontrolle të përgjithshme dhe specialitike;
- 56 kontrolle stomatologjike,
- 94 shërbime të marra në nivelin sekondar;
- 211 shërbime të marra në nivelin terciar;
- 153 shërbime Ergoterapeutike (terapisë së punës);
- 370 shërbime të fizioterapisë;
- 1,485 dhënie terapisë paraneterale;
- 264 shërbime diagnostike laboratorike dhe imazherike jashtë ISSh.




### 3.6 Furnizimi me barna për KPSH

Me qëllim të sigurimit të barnave të institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë ka vazhduar furnizimin e këtyre institucioneve me barna dhe material shpenzues nga lista esenciale sipas planifikimit të vet institucioneve, me porosi të rregullta dhe emergjente.

#### *Indikatorët bazë të performancës*

- Janë siguruar barna për 34 QKMF me porosi të rregullta dhe emergjente;
- 85% furnizimi me barna;
- 90% furnizimi me material shpenzues;
- 100% furnizimi me insulina;
- 26 produkte të reja për barna e sëmundjeve të rralla;
- 100% furnizimi me vaksina;
- 100% furnizimi me terapi antituberkulare dhe ARV;
- 100% furnizimi me barna për programe specifike fibroza cistike, okrelizumab, dornase alfa, interferon Beta1a22mcg, Interferon Betalamcg, interferon Beta1b 250mcg, taliglucerase, imiglucerase.



Garfika 1. Niveli i furnizimit me barna 2024

### 3.7. Komunikimi me publikun

Ministria e Shëndetësisë/Divizioni i Komunikimit me Publikun ka qenë kryesisht i fokusuar në prezantimin e aktiviteteve të Ministrisë të ndërlidhura me prioritetet kryesore, siç janë miratimi i politikave të reja, promovimi i aktiviteteve ku është përmirësuar infrastruktura, dhe pajisjet në institucionet shëndetësore, furnizimi me barna, si dhe fushatat për vetëdijesimin e publikut rreth shëndetit publik, me theks promovimi i kampanjës për përzgjedhjen e mjekut familjar në zonën e banimit, procesi i vaksinimit kundër gripit sezonal, dhe shënimi i ditëve dhe javëve botërore të shëndetit publik

#### *Indikatorët bazë të performancës*

- 1,359 publikime në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë;
- 1,546 përgjigje të ofruara për media;
- 937 përgjigje të ofruara për palë të interesuara;
- 84 komunikata të lëshuara për media;
- 17 ftesa të përgatitura për media;
- 10 njoftime të përgatitura për media;
- 3 intervista për media;
- 8 përgjigje për Agjencinë për informim dhe privatësi;
- 126 kërkesa për qasje në dokumente publike.

### 3.8 Zhvillimi i sistemit të informimit shëndetësor

Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar moduli për përzgjedhje të mjekut familjar dhe është mundësuar ndërlidhja dhe integrimin e sistemit për mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse në kuadër të sistemit BHIS ku të gjitha institucionet në KPSH do të mund të raportojnë sëmundjet ngjitëse bazuar në Ligjin Nr.08/L-200 për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse. Në kuadër të SMSF-së është zhvilluar moduli për planifikim dhe dispensim të Metadon-it, i cili përfshin planifikimin, furnizimin, dispensimin dhe janë përditësuar modulet ekzistuese. Në zbatim të Planit Strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030 është zhvilluar “Digital Health Blueprint” – instrument i qartë për shtrirjen e plotë të sistemit të informimit shëndetësor në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor.

#### *Indikatorët bazë të performancës*

- Një (1) plan strategjik për SISH 2024-2030, i miratuar;
- Ndërlidhja e sistemit të Mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse me sistemin dhe ARC e përfunduar;
- Lancimi në platformën e-kosova për rezultatet gjeneruara nga sistemi MEDLIS;
- Ndërlidhja e sistemit SMSN- BHIS e realizuar;
- Lista me kode të institucioneve në KPSH për ndërlidhjen e sistemeve BHIS dhe SMSN e përgatitur;
- Një (1) Modul për Metadon i zhvilluar;
- Trajnimet për përdorim të SMSF në SHSKUK të zhvilluara;
- Aplikimi online për specializime i funksionalizuar;
- Llogaritë për mentorët klinikë të krijuara;
- Blue Print i aprovuar;
- Qeverisja e- shëndetësia e themeluar;
- Sistemi për mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse i funksionalizuar;
- Moduli TB i integruar në sistemin për mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse;
- Sistemi Medlis i funksionalizuar;
- Përkrahje teknike me rrjet qeveritar dhe infrastrukture harduerike për institucionet shëndetësore e siguruar;

### 3.9. Asistenca teknike dhe marrëveshjet financiare

Në kuadër të koordinimit të asistencës teknike, Ministria ka marrë konfirmimin nga Ministria e financave punës dhe transfereve që projekti kredisë i financuar nga Banka Botërore “Qasja gjithëpërfshirëse e Kosovës për forcimin e sistemit të shëndetësisë,” është proceduar në kuvend për miratim. Sa i përket, Planit strategjik për sigurimin e pajisjeve për të gjitha institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor, Ministria është në proces të finalizimit të diskutimeve rreth financimit me Bankën zhvillimore të Këshillit të Evropës dhe Bankën investuese të Evropës.

#### *Indikatorët kyç të performancës*

- Është në proces të zbatimit studimi i fizibilitetit “Ndërtimi dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës në Sektorin e Shëndetësisë në Kosovë WB21-KOS-SOC-01”;
- Një (1) marrëveshje e nënshkruar me EBA për donacionin për meremetimin e Spitalit dhe QKMF Vushtri;
- Një (1) marrëveshje e nënshkruar me Federatën botërore të Hemofilisë me seli në Karada;
- Një (1) marrëveshje e nënshkruar me Ambasadën Zvicerane për projektin e AQH faza e II;
- Një (1) marrëveshje e nënshkruar në mes Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Kroacisë;
- Një (1) kërkesë e përgatitur dhe e proceduar për asistencë teknike përmes TAIEX për mbështetje të grupit punues për hartimin e projektligjit për shëndet mendor;
- Një (1) qarkore është hartuar dhe proceduar për procedurat e pranimit të donacioneve në Departament për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Komunë;

- Një (1) kërkesë e proceduar për donacion të barnave anti tuberkulare në Agjencinë Evropiane të Emergjencave;
- Një (1) raport i përgatitur për donacione për vitet 2022-2024.

### **3.10. Licencimi dhe akreditimi i institucioneve shëndetësore**

Gjatë periudhës raportuese departamenti për licencim, cilësi, siguri dhe akreditim të institucioneve shëndetësore ka pranuar aplikacione për licencim të institucioneve private shëndetësore dhe është angazhuar në trajnimin për metodologjinë e hartimit të udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike. Gjithashtu janë finalizuar termat e referencës koordinatorë të cilësisë në institucionet shëndetësore

#### ***Indikatorët bazë të performancës***

- 7 institucion spitalor i licencuar;
- 467 institucione jashtë spitalore të licencuara;
- 30 institucione të licencuara për ndërrim adrese;
- 54 institucione jo spitalore- veprimtari shtesë të licencuara;
- 136 institucione të refuzuara;
- 10 institucione të pezulluara;
- 55 institucione të shuara;
- 3 institucione të revokuara;
- 659 fletëpagesa për aplikim / licencim 522,901.00 euro.

### **3.11 Inspektimet**

Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit është bërë përmes inspektorateve respektive ku, gjatë vitit 2024 janë realizuar 15,503 inspektime shëndetësore, farmaceutike dhe sanitare. Numri më i madh i inspektimeve ishin sanitare 13,088, pasuar me ato shëndetësore 1200 dhe farmaceutike 1215.

#### ***Indikatorët bazë të performancës***

- 1, 200 inspektime shëndetësore (të planifikuara 750, të paplanifikuara 142, ri inspektime 93, specifike 134, tematike 81);
- 171 vendime të shkallës së parë me vlerë prej 311,750.00 euro;
- 65 vendime të shkallës së dytë (inspektorati shëndetësor 36, inspektorati farmaceutik 29);
- 13, 088 inspektime sanitare të realizuara;
- 48 lëndë për në avokaturën shtetërore;
- 1, 966 fletëparaqitjeve/gjobave;
- 7 vendime të shkallës së dytë;
- 1, 215 inspektime farmaceutike (të planifikuara 941, të paplanifikuara 274);
- 173 gjoba të shqiptuara;
- 173 vendime.

### **3.12 Pajisjet dhe produktet mjekësore**

Në fushën e pajisjeve dhe produkteve mjekësore është vazhduar me vlerësimin e dokumentacionit në procesin e lëshimit dhe ripërtëritjes të certifikatave të autorizim marketingut, vlerësimin të variacioneve si dhe aktivitetet e farmakovigjilencës me referencë të veçantë për aktivitetet e menaxhimit të rrezikut, aktivitetet e licencimit të veprimtarive, lejeve të importit dhe analizat laboratorike të kontrollit cilësisë.

#### ***Indikatorët bazë të performancës***

- 1, 738 aplikime për Variacione të produkteve sipas dispozitave të Udhëzimit Administrativ UA 01 /2015 dhe UA 01/2024;
- 374 aplikime për autorizim marketing;

- 425 aplikime të ri-përtrira për autorizim marketing;
- 5, 876 aplikime për importin e pajisjeve medicinale;
- 86 aplikime për eksportin e pajisjeve medicinale;
- 2, 250 aplikime për importin e produkteve medicinale;
- 20 aplikime për eksportin e produkteve medicinale;

## 4. Pasqyra e performancës financiare

Gjatë periudhës raportuese sipas programeve buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike, Ministria e Shëndetësisë ka barazuar gjendjen fizike me atë elektronike të transaksioneve për vitin me programet vartëse dhe programet tjera. Është bërë raportimi i pasqyrave vjetore financiare. Në tabelën e mëposhtme janë të pasqyruara shifrat e shpenzimeve sipas kategorive buxhetore dhe pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Ministrinë e Shëndetësisë.

		2024				2023	2022
		Realizimi A € '000	Buxheti final B € '000	Buxheti fillestar C € '000	Ndryshimi D=B-A € '000	Realizimi E € '000	Realizimi F € '000
<b>HYRJA E PARASË SË GATSHME</b>							
	Shënime						
	Të hyrat tatimore	8			-		
	Të hyrat jo tatimore	9	2,345	2,345	6,827	6,123	5,842
	Të hyrat e dedikuara	10			-		
	Grantet e përcaktuara të donatorëve	11	341	341	-	191	821
	Tjera	12			-		
	<b>Gjithsej Pranimet</b>		<b>2,686</b>	<b>2,686</b>	<b>6,827</b>	<b>6,314</b>	<b>6,663</b>
<b>DALJA E PARASË SË GATSHME</b>							
	Paga dhe shtesa	2	16,219	16,259	14,575	13,032	10,777
	Mallra dhe shërbime	3	27,006	30,365	29,446	19,452	17,970
	Shpenzime komunale	4	231	289	282	219	183
	Transfere dhe subvencione	5	3,369	3,614	3,614	4,978	3,779
	Shpenzime kapitale	6	10,481	18,504	32,479	7,810	3,036
	Rezerva				0		
	Tjjerat	7			-		
	<b>Gjithsej pagesat</b>		<b>57,306</b>	<b>69,031</b>	<b>80,395</b>	<b>45,491</b>	<b>35,744</b>

Tabela 1. Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit

Sa përket performancës financiare Ministria ka arritur të ketë një nivel të lartë të shpenzimit me një vlerë prej 57.3 milion euro krahasuar me dy vitet paraprake ku niveli i shpenzimit në 2022 ishte 35,7 milion euro, respektivisht 45,4 milion euro në 2023.




Tabela 2. Krahasimi i shpenzimeve buxhetore për vitet 2022-2024

Grafiku në tabelën 2, paraqet totalin e shpenzimeve buxhetore për vitet 2022-2024, ku vërehet rritje e ndjeshme nga viti 2022 në 2024, duke reflektuar një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve.

#### **4.1 Shpenzimet kapitale dhe projektet**

Investimet kapitale në vitin 2024 janë kryesisht vazhdimësi e projekteve nga vitet e kaluara të cilat nuk kanë mundur të fillojnë me kohë si rrjedhojë e projekteve të mangëta dhe jo profesionale. Gjithsesi Ministria me qëllim të shfrytëzimit optimal të mjeteve për investime kapitale gjatë vitit 2024 ka ndërmarrë hapat e nevojshme që projektet kapitale të parapara për vitin 2025 dhe mjetet e ndara financiare për këtë qëllim të shfrytëzohen maksimalisht dhe brenda afatit të përcaktuar.

##### ***Indikatorët bazë të performancës***

- Ri projektimi i Spitalit të Ferizajt është nënshkruar kontrata në vlerë 66,788.00 euro.
- QKMF-së ne Istog punët e kryera dhe të paguara 408,829.96 euro;
- Është nënshkruar kontrata me kompanisë punë kryese për ndërtimin e QKMF Drenas; vlera e kontratës: 2,929,292.92 euro;
- Është nënshkruar kontrata me kompanisë punë kryese për ndërtimin QKMF Istog – Vlera e kontratës: 2,364,142.95 euro;
- QKMF Shtime- Është bërë inicimi i procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e operatorit ekonomik;
- QKMF Ferizaj - punët e kryera dhe të paguara në 2024: 1,264,711.60 euro;
- Depoja Qendrore e Barnave Është nxjerr nga Qeveria e Kosovës vendimi i parë dhe vendimi preliminar për shpronësim.
- Adaptimi i Spitalit Covid në Qendrën Mjekësore Emergjente - Në procedura të prokurimit;
- Depo farmaceutike në Spital të Mitrovicës - Kontrata e nënshkruar; vlera e kontratës: 142,027.89€.

#### **4.2 Prokurimi**

Sa i përket prokurimit publik, Ministria e Shëndetësisë në vitin 2024 ka planifikuar 147 për furnizime, shërbime dhe punë ku janë nënshkruar 285 kontrata me një vlerë totale prej 41,252,919.65 €. Këto kontrata përfshijnë një shumëllojshmëri aktivitetesh të prokurimit që mbulojnë nevojat e Ministrisë së Shëndetësisë në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë furnizime me pajisje mjekësore, shërbime ndihmëse dhe ndërtimin e objekteve të reja. Në total, janë regjistruar 57 ankesa, gjatë procedurave të prokurimit ku 39 ankesa janë në favor të Autoritetit kontraktues, 5 ankesa janë pjesërisht të bazuara, ku janë identifikuar disa elemente që kërkojnë rishikim ose sqarim të mëtejshëm dhe 13 ankesa janë të natyrës së ri-vlerësimit, që kërkojnë një analizë të mëtejshme të ofertave dhe procesit të vlerësimit, për të siguruar që çdo aspekt i procedurës është zbatuar në përputhje me rregullat dhe kriteret e përcaktuara.

##### ***Indikatorët bazë të performancës***

- 147 aktivitete të zhvilluara për procedura të ndryshme prokurimi për furnizime, shërbime dhe punë;
- 285 kontrata të nënshkruara me vlerën totale prej 41,252,919.65 €;
- 1,234 urdhër blerje të proceduara;
- 57 ankesa (39 ankesa në favor të Autoritetit Kontraktues, 5 ankesa pjesërisht të bazuara, 13 ankesa për ri-vlerësim).

## **5. Zbatimi i rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe të njësisë së brendshme të auditimit**

Në kuadër zhvillimeve nga fusha e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe njësi vartëse, gjatë vitit 2024 janë realizuar aktivitete të ndryshme të cilat janë identifikuar si fushë auditimi më të ekspozuara ndaj rreziqeve, të cilat janë ndërmarrë bazuar në planin vjetor të punës.

### ***Indikatorët bazë të performancës***

- 12 procese të auditimit ( 8 procese të rregullta dhe 4 procese me kërkesë të menaxhmentit);
- 20 rekomandime (19 rekomandime janë adresuar plotësisht ndërsa 1 rekomandim nuk është adresuar);
- 14 rekomandime të kaluara për zbatim nga viti 2023 (8 rekomandime janë zbatuar, 5 janë në proces ndërsa 1 nuk është adresuar).

### **5.1 Zbatimi i rekomandimeve të Zyrës kombëtare të auditimit për PVF 2022**

Raporti i Zyrës kombëtare të auditimit për pasqyrat vjetore financiare 2023 të Ministrisë së Shëndetësisë ka evidentuar gjashtë (6) të gjetura. Ministria nuk është pajtuar për dy të gjetura. Për adresimin e këtyre të gjeturave dhe adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra kombëtare të auditimit (ZKA), Ministria në vitin 2024 ka hartuar planin për zbatimin e rekomandimeve të ZKA për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2023.

### ***Indikatorët bazë të performancës***

- Tri (3) rekomandime të zbatuara;
- Një (1) rekomandim në proces të zbatimit.

### **5.2 Zbatimi i rekomandimeve të Zyrës së Avokatit të popullit**

Sa i përket zbatimit të rekomandimeve të Zyrës së Avokatit të popullit, gjatë vitit 2024 në vazhdimësi Ministria ka adresuar rekomandimet e dala nga raporti në institucionet relevante dhe përgjigjet e pranuar nga institucionet përgjegjëse janë përcjellë Zyrës së Avokatit të popullit;

- Njëzetë (20) rekomandime janë zbatuar;
- Shtatë (7) rekomandime janë adresuar dhe janë në proces;
- Katër (4) rekomandime janë të pa zbatueshëm.

## **6. Planet për vitin e ardhshëm**

Ministria e Shëndetësisë gjatë vitit 2025 synon të fillojë zbatimin e objektivave strategjike të përcaktuara me Strategjinë Sektoriale të shëndetësisë 2025-2030, të reflektuara edhe me Planin kombëtar për zhvillim 2025-2027 dhe Planin Kombëtar për Integrim Evropian 2025-2027.

Në kuadër të riorganizimit të sektorit të shëndetësisë parashihet vazhdimi i plotësimit të kornizës ligjore, hartimi i politikave dhe standardeve, fuqizimi i kapaciteteve monitoruese, vazhdimi i zhvillimit të sistemit të informimit shëndetësor.

Sa i përket ruajtjes dhe përparimit të shëndetit gjatë vitit 2025 fokusi, do të vihet në shëndetin publik, grupet e cënueshme, avancimin e konceptit të mjekësisë familjare, hartimin e planeve për skринing dhe ngritjen e bashkëpunimit regjional në shëndetësi si dhe përcaktimin e standardeve për sigurim të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore.

Për të siguruar financimin e qëndrueshëm në shëndetësi gjatë këtij viti parashihet të plotësohet korniza ligjore me akte nënligjore për sigurim shëndetësor dhe zhvillimi i aktiviteteve për fuqizimin e kapaciteteve të fondit të sigurimit shëndetësor.

Një ndër prioritetet do të jetë edhe furnizim i vazhdueshëm i KPSH me kërkesa të rregullta dhe emergjente për barna dhe material shpenzues.

## **7. Sfidat**

- Nivel jo i kënaqshëm i zbatimit të Planit Kombëtar për Zhvillim;
- Niveli i ulët i hartimit dhe finalizimit të Udhërrëfyesve klinik dhe protokolleve klinike;
- Vonesat në vendimmarrje nga OSHP që ka ndikuar për nivel të ultë të zbatimit të projekteve kapitale.